



Pranimar / Dërruzat Pamitjena / Prodato Received / Delivery	14.02.2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicima Quantity
SKIMSHK	752/2022		113



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.04/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Kocanëtarë dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.04/2022 të datës 05.01.2022 e parashtruar nga ankuesja me adresë Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 14.02.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. OBLIGOHET** Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesën e datës 25.11.2021 të parashtruar nga ankuesja

**II.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**A r s y e t i m**

Ankuesja sipas Akt Emërimit të datës 01.02.2017 me 01nr.112-986 është e sistemuar në vendin e punës “Zyrtare për shërbim me qytetar”, e cila me datë 25.11.2021 me numër protokollit 14-070/01-256374/21 ka parashtruar kërkesë tek Udhëheqësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës për “*transfer të përlershëm brenda Shërbimit Civil*”, mirëpo ankuesja nuk merr përgjigje lidhur me kërkesën e saj dhe me datë 05.01.2022 me numër të protokollit 06/2022 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 12.01.2022 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankueses nga Komuna e Prishtinës, ndërsa Këshilli më datë 24.01.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/8.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesa e ankueses e datës 05.01.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 12.02.2021 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Kërkesa e ankueses e datës 25.11.2021; Raporti mjekësor i datës 04.06.2021, Raporti i Komisionit Konziliar i Reumatologëve e datës 02.03.2021; Vendimi i datës 03.09.2012 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Akt emërimi i datës 27.08.2013; Akt emërimi i datës 01.02.2017; Kërkesa e datës 05.03.2021; E-mail i datës 11.02.2022 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për vendosjen e kësaj çështje, duke u bazuar në nenin 16 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e parashtruara të lëndës dhe ka konstatuar që ekziston baza ligjore për të vendosur, duke *obliguar* organin e punësimit, respektivisht Udhëheqësin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës që ti ndërmarr të gjitha veprimet, për të vendosur lidhur me kërkesën e ankueses

*sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara nga organi i punësimit ka konstatuar se ankuesja *marrëdhënien e punës e ka themeluar sipas Akt Emërimit të datës 27.08.2013 me numër 01-122-986 në vendin e punës "Zyrtare e Lartë në Zyrën Pritëse" në Qendrën për Shërbime me Qytetar me koeficient gjashtë (6), ndërsa me datë 09.03.2017 nënshkruan Akt Emërimin në vendin e punës "Zyrtare për Shërbim me Qytetar" në Njësinë Qendra për Shërbimet me Qytetar.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha dëshmitë e ofruara nga ankuesja dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankuesja me datë 25.11.2021 ka parashtruar kërkesë me numër protokolli 14-070/01-256374/21 tek Udhëheqësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, me te cilën ka kërkuar që ti mundësohet transferimi i përhershëm brenda shërbimit civil për shkaqe shëndetësore respektivisht ti mundësohet transferimi i përhershëm nga pozita „Zyrtare për shërbim me qytetar“, në pozitën „Zyrtare për Shërbime Sociale 1“ apo në ndonjë pozitë tjetër në këtë drejtori.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave gjithnjë duke u bazuar në provat e lëndës ka konstatuar se deri me tani organi i punësimit respektivisht Komuna e Prishtinës nuk e ka shqyrtuar kërkesën me numër protokolli 14-070/01-256374/21 të datës 25.11.2021 të parashtruar nga ankuesja, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ne pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik përkatësisht me dispozitat e nenit 53 paragrafin 1 si dhe dispozitat e nenit 11 paragrafin 1 dhe 3 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, ka konstatuar se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të institucionit si njësi përgjegjëse për institucionet e tjera, është kompetent për vendosjen e transferimit të përhershëm për arsye të paafëtisë shëndetësore



Andaj, duke marr parasysh rrethanat si me lartë, Kolegji konstaton se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, është i obliguar që të shqyrtoj kërkesën e datës 25.11.2021 të parashtruar nga ankuesja si dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.04/2022**

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- Ankueses
- Kryetarit të Komunes së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.